



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 60 Prot.

Tiranë, më 23 / 01 / 2017

**Lënda :** Dërgohen rekomandime për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116 të datës 29.3.1996, “Kodi i Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Drejtuar :** Z. Fatmir XHAFAJ  
Kryetari i Komisionit  
Komisioni Për Çeshtjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

**I nderuar zoti Kryetar i Komisionit !**

Në vijim të kërkesës së Komisionit Për Çeshtjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron sa më poshtë vijon disa rekomandime në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116 të datës 29.3.1996, “Kodi i Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Së pari:** Pasi u njohëm me përmbajtjen e projektligjit dhe ndryshimet që ai propozon, në nenet e Kodit të Procedurës Civile, konstatojmë se, nuk ka anjë parashikim për të ndryshuar barrën e provës gjatë procesit civil në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, një kërkesë kjo e direktivave të Bashkimit Europian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Ligji Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në Kreun VI “Procedurat përpara gjykatës”, ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: “Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, personi që pretendon se ndaj tij nuk është respektuar parimi i trajtimit të barabartë e ka tepër të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat dhe ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Nevoja për zbatimin e parimit të zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës në çështjet e diskriminimit me qëllim garantimin e efektivitetit të ligjit për barazinë, u pranua për herë të parë nga Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED)<sup>1</sup> në vendimet e veta në çështjet *Danfoss*<sup>2</sup> dhe *Enderby*<sup>3</sup>. Për këtë arsye Bashkimi Europian ka integruar në legjislacionin antidiskriminim parimin e zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës. Në dhjetor të vitit 1997, Këshilli Europian ka miratuar Direktivën 97/80 për barrën e provës në çështjet e diskriminimit për shkak të gjinisë. Në këtë direktivë parashikohet: “*Shtetet Anëtare do të ndërmarrin masa të tilla sipas nevojës, në përputhje me sistemet e tyre kombëtare juridike, për t’u siguruar se, kur personat që konsiderojnë se u është bërë një e padrejtë për shkak të moszbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, sjellin përpara një gjykatë apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent, fakte nga të cilat mund të supozohet se ka patur diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, atëherë do të jetë detyra e të paditurit të vërtetojë se nuk ka patur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë*”<sup>4</sup>

I njëjti formulim përdoret edhe në direktivat e mëvonshme në fushën e mosdiskriminimit, të cilat janë: Direktiva e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”, Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”, Direktiva e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”, Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006

<sup>1</sup> Sot emërtimi i saj është: Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian.

<sup>2</sup> Çështja nr. 109/88

<sup>3</sup> Çështja nr. 127/92

<sup>4</sup> Përkthim jo zyrtar



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet t’a kishte paditësi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi vërteton rastin *prima facie* -“në pamje të parë”<sup>5</sup>, atëherë i kërkohet të paditurit, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, e shtrin zbatimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, Kodin e Procedurave Administrative (Kodi i ri), dhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, është harmonizuar dhe rregulluar shpërndarja e barrës së provës lidhur me çështjet e diskriminimit në sektorin publik. Me qëllim rregullimin dhe harmonizimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit edhe në sektorin civil, është e nevojshme që një parashikim i tillë të shtohet edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Kodi i Procedurës Civile është ligji bazë për procedurat që gjykatat duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga këndvështrimi i garantimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi. Në bazë të nenit 81 të Kushtetutës, Kodi i Procedurës Civile është një ligj i cili miratohet me një shumicë prej 3/5, duke qënë në këtë mënyrë në një nivel më të lartë në hierarkinë e normave, se sa ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë, përfshirë këtu ligjin nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Në këtë rast gjykatat do të gjenden midis kërkesave të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i cili ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë pretendimin e saj.

Sa më sipër dhe me qëllim përfarimin e legjislacionit me *acquis communautaire* të BE-së dhe harmonizimin e legjislacionit të brendshëm propozojmë:

- **Shtimin e një paragrafi, pas paragrafit të parë të nenit 12, të ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me përmbajtje si vijon:**

<sup>5</sup> Paditësi sjell fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshme.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

*“Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

**Së dyti:** Rekomandimi i dytë ka të bëjë me përmbajtjen e nenit 35 të projektligjit, sipas të cilit, pas nenit 224/ç, shtohet një nen i ri, 224/d, i cili ka të bëjë me regjistrin online të ekspertëve. Në vlerësimin tonë, parashikimet që bëhen në pikën 3 të këtij neni, kanë nevojë të rishikohen, si parashikime të paqarta dhe që mund të gjenerojnë situata diskriminuese. Konkretisht, në pikën 3, parashikohet: “.....3. Në mënyrë që të pranohen në këtë listë, ekspertët duhet të provojnë se përmbushin kushtet e mëposhtme:

- a) Dhjetë vjet përvojë, mundësisht në një funksion të përgjegjshëm në një veprimtari profesionale, në fushë specifike apo të ngjashme, menjëherë para regjistrimit; një veprimtari pesë-vjeçare e këtij lloji është e mjaftueshme nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse;
- b) Aftësi të plotë juridike;
- c) Aftësi fizike dhe mendore;
- d) Besueshmëri;
- e) Financa të mirë-rregulluara.”

**Në lidhje me parashikimin e gëmës “a”**, vlerësojmë se ka nevojë që të rishikohet me qëllim që të qartësohet kushti në fjalë. Veçanërisht e paqartë është se, çfarë kuptohet me “funksion të përgjegjshëm”.

**Në lidhje me parashikimin e gërmës “b”**, “aftësi e plotë juridike”, vlerësojmë se nuk është një term juridik. Ndoshta termi “aftësi e plotë juridike” ka parasysh termin “zotësi e plotë juridike”. Megjithatë edhe me saktësimin e termit mendojmë se një parashikim i tillë nuk duhet të jetë pjesë e kushteve për të qënë pjesë e listës së ekspertëve, pasi do të sillte diskriminim të personave për shkak të aftësisë së kufizuar.

Shqipëria ka ratifikuar pa asnjë rezervë Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”. Ky akt ndërkombëtar tashmë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, parashikon në nenin 12 të saj se : “ Shtetet palë riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e njohjes kudo si persona para ligjit. 2. Shtetet palë do të pranojnë se personat me aftësi të kufizuara gëzojnë zotësi ligjore në bazë të barabartë me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës..... ” .



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Një parashikim i ngjashëm me kushtin e vendosur nga gërma “b”, e gjejmë në shume nga ligjet tona. Konventa parashikon detyrimin për shtetet që të mos miratojnë legjislacion që bie në kundërshtim me parashikimet e saj dhe paralelisht të shfuqizojnë parashikimet ligjore të miratuara para miratimit të saj.

**Sa më sipër, rekomandojmë që kushti i parashikuar nga gërma “b” të hiqet, pasi diskriminon personat me aftësi të kufizuara.**

*Në lidhje me parashikimin e gërmës “c”, “Aftësi fizike dhe mendore”,* vlerësojmë se në të njëjtën mënyrë si parashikimi i pikës “b”, diskriminon personat për shkak të aftësisë së kufizuar. Ky parashikim përjashton personat me aftësi të kufizuara nga e drejta për të marrë statusin e ekspertin, duke mos lejuar që ata të gëzojnë në baza të barabarta me të tjerët të drejtën për punësim dhe profesion. Konventa e OKB-së, por tashme edhe legjislacioni kombëtar i miratuar rishtaz për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ndalon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara dhe synon përfshirjen e tyre në të gjitha aspektet e jetës dhe eliminimin e të gjitha barrierave.

**Sa më sipër, rekomandojmë që kushti i parashikuar nga gërma “c” të hiqet, pasi diskriminon personat me aftësi të kufizuara.**

*Në lidhje me parashikimin e gërmës “e”, “Financa të mirë-rregulluara”,* vlerësojmë se ka nevojë që qartësohet se çfarë kuptohet me këtë term. Paqartësia e këtij termi mund të sjellë diskriminim për shkak të gjëndjes ekonomike.

**Sa më sipër, rekomandojmë që kushti i parashikuar nga gërma “e” të rishikohet me qëllim qartësimin e saj, në mënyrë që të parandalohen situata diskriminuese.**

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)